



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.75.
Prishtinë, më 12.4.2024, në orën 10:00.
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, Enis Kervan, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Jahja Kokaj, dhe Adriana Matoshi anëtarë.

Munguan: Albena Reshitaj, Eliza Hoxha, Vlora Dumoshi dhe Ardian Kastrati.

Pjesëmarrës tjerë: Arbërie Nagavci ministre e MASHTI, përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri.

Mbledhjen e kryesoi Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19 dhe 21.4.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L207 për Tekste Shkollore.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua nga të pranishmit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19 dhe 21.4.2024;

Procesverbalet e mbledhjes së mbajtur me datë 19 dhe 21.3.2024 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L207 për tekstet shkollore

Ardian Gola tha se referuar projektligjit në fjalë, pas kalimit të tij në lexim të parë, në përputhje me vendimin e kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, Komisioni ka formuar grupin punues për shqyrtimin nen për nen të të njëjtit, me ç'rast sipas procedurës dhe praktikës parlamentare, e ftuar në këtë mbledhje ka qenë edhe ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci.

Arijeta Rexhepi, kryesuese e Grupit Punues bëri prezantimin e punës së grupit punues, përfshirë amendamentet e dala lidhur me Projektligjin për tekstet shkollore. Ajo theksoi se në këto amendamente, gjithsej 11, janë diskutuar dhe përfshirë po ashtu edhe propozimet që janë bërë gjatë dëgjimit publik, për të vazhduar më pas në shqyrtim të secilit prej amendamenteve veç e veç.

Më tej prezantoi amendamentet në Projektligjin nr.08/L-207 për Tekste Shkollore, si vijon:

Amandamenti 1

Neni 2, paragrafi 1, ndryshohet si në vijim:

1.Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

Amandamenti 2

Neni 4, paragrafi 3, në fund të nenit shtohet teksti: “dhe në alfabetin Braile”.

Amandamenti 3

Neni 5, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

1.Tekstet shkollore dhe materialet mësimore për lëndët nacionale dhe të përgjithshme të komuniteteve joshumicë, kalojnë në të njëjtat procedura të vlerësimit, përzgjedhjes dhe botimit të përcaktuara në këtë ligj.

Amandamenti 4

Neni 5, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

2.Për tekstet e lëndëve të përgjithshme të komuniteteve joshumicë, përcaktimi i lëndëve, kriteret dhe procedurat e tjera për përkthim dhe botim pas pranimi të vendimit për botim të teksteve të miratuara në gjuhën shqipe, rregullohen me akt nënligjore të nxjerr nga Ministria.

Amandamenti 5

Neni 5, pas paragrafit 5, shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje:

6.Tekstet shkollore dhe mjetet mësimore për mësimin e gjuhës dhe kulturës së komuniteteve joshumicë në diasporë e mërgatë rregullohen me marrëveshje të Ministrisë së Arsimit me shtetet amë;

Amandamenti 6

Neni 5, pas paragrafit 5, shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje:

7. Lëkytra shkollore në gjuhët e komuniteteve joshumicë përcaktohen në përputhje me planin dhe programin mësimor të klasës dhe lëndës përkatëse si dhe rregullohen me marrëveshje të Ministrisë së Arsimit me shtetet amë;

Amandamenti 7

Neni 9, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

1.Për klasën parafillore (grup-mosha 5 deri në 6 vjeç) përgatiten pako të veçanta edukative, interaktive dhe multimediale të cilat përfshijnë materiale edukative dhe mjete didaktike adekuate për këtë grup-moshë për t'u mundësuar fëmijëve një zhvillim dhe edukim sa më cilësor.

Amandamenti 8

Neni 18, nenparagrafi 2.11, ndryshohet si në vijim:

2.11. Përbërja, struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse, përcaktohen me akt të veçantë nënligjor nga Ministria përkatëse, duke siguruar mbulueshmëri me zyrtarë dhe profesionistë përkatës.

Amandamenti 9

Neni 26, nenparagrafi 1.1, ndryshohet si në vijim:

1.1. Legjislacioni përkatës në fushën e arsimit;

Amandamenti 10

Neni 40, pragrafi 4, ndryshohet si në vijim:

4.Nëse vërtetohet se një anëtar i cili ka marrë pjesë në procedurën e dhënies së vlerësimit të ekspertit, mendimit të ekspertit ose ka marrë pjesë në proces dhe në një formë ka ndikuar në përzgjedhjen apo vendimin final për një tekst shkollor, material mësimor ose mjet shkollor ka dhënë një deklaratë të pasaktë nën betim, i njëjti nuk mund të riemërohet në asnjë prej ekipeve dhe komisioneve të përcaktuara me këtë ligj për 5 vite me radhë, si dhe merren masa në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Amandamenti 11

Neni 42, ndryshohet si në vijim:

Neni 42

Aktet nënligjore

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, nxerren nga Ministria në afat prej gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Pas prezentimit të amendamenteve anëtarët e Komisionit me gjashtë (6) vota për asnjë kundër votuan amendamentet dhe Projektligji së bashku me to u procedua për shqyrtim tek Komisionet e përhershme për vlerësim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola

Kryetar i Komisionit